



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET
MINISTRI**

Luan MEMUSHI

PROGRAMI I LËNDËS

SË DITURI NATYRËS

KLASA III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

TIRANË, 2005

HYRJE

Lënda “Dituri natyre”, si nismëtare për njohjen shkencore të natyrës e ligjeve të saj, i ndërgjegjëson nxënësit për njohuritë e fituara nëpërmjet marrëdhënieve të vazhdueshme me natyrën. Ajo ndikon në zgjerimin dhe saktësimin e njohjes shkencore, duke krijuar kështu përfytyrimet fillestare, shkencore, të nxënësve për natyrën.

Lënda “Dituri natyre” në arsimin e detyruar nëntëvjeçar zhvillohet gjatë tri viteve të ciklit fillor, në klasën e tretë, të katërt dhe të pestë, me 2 orë në javë për secilën klasë.

Programi mësimor i kësaj lënde mbështetet në integrimin lëndor të linjave të mëposhtme:

1. Gjallesat dhe proceset e jetës;
2. Mjedisi fizik;
3. Vendet dhe njerëzit;
4. Lëndët dhe vetitë e tyre.

Këto linja bashkë me përmbajtjet përkatëse mbulojnë informacionin e nevojshëm fillestar, që duhet të marrë nxënësi për njohjen shkencore të natyrës. Ato, ndonëse me shtrirje të ndryshme, përfshihen në të gjithë lëndën e dituri natyrës, nga klasa e tretë deri në klasën e pestë. Megjithatë, në varësi të veçorive psikologjike moshore dhe të të nxënit, disa linja në programin e klasës së tretë studiohen më pak se të tjerat. Kështu, p.sh., linja për lëndët dhe vetitë e tyre, për vetë vështirësitë konceptuale që mbart për moshat e vogla shkollore, studiohet më pak në krahasim me linjat e tjera, të cilat japin informacion më konkret dhe të kapshëm për nxënësit.

Përmbajtja e secilës linjë për një klasë të caktuar është menduar të jetë e lidhur me përmbajtjet e po asaj linje për klasat e tjera dhe me përmbajtjet e linjave të tjera, ku ato kanë objekt të përbashkët.

Programi parashikon si objekt integrimi zhvillimin e aftësive, të shkathtësive dhe të shprehive të njohjes shkencore të nxënësit, i cili do të realizohet përmes të gjitha linjave të përmbajtjes.

Në klasën e tretë nxënësit do të konceptojnë lëndën përmes vëzhgimit të saj në lloje të ndryshme objektesh. Ata do të përshkruajnë vetitë e lëndëve në lidhje me përdorimet e tyre, si dhe do të shohin ngjashmëritë dhe ndryshimet në vetitë e lëndëve në lidhje me pamjen, ndijimin, të dëgjuarit, dhe ndryshimet që ato pësojnë. Gjithashtu, ata do të mësojnë se të maturit është një proces shkencor dhe do ta zbatojnë në matjen e gjatësisë, të vëllimit, masës dhe temperaturës së trupave të ndryshëm. Ata do të përfshihen dhe do të zhvillojnë një sërë veprimtarish praktike, që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të matjes. Si njësi matëse jepen ato të sistemit SI.

Nxënësit do të përcaktojnë lëvizjen dhe faktorët që e shkaktojnë atë, si dhe do të dallojnë lëvizjet rreth tyre, do të përshkruajnë tipa e ndryshmetë lëvizjes, duke bërë lidhjen ndërmjet saj dhe forcës. Gjithashtu, nxënësit do të kryejnë veprimtari të ndryshme, për të mësuar rreth magnetëve. Ata do të përcaktojnë llojet e lëndëve, që tërhiqen nga magnetët, si dhe do të eksperimentojnë mënyrat me anë të të cilave magnetët ushtrojnë forcë mbi trupat, në largësi të ndryshme. Me anë të veprimtarive, nxënësit do të zbulojnë që magnetët kanë dy pole, të cilat tërheqin ose shtyjnë polet e një magneti tjetër. Veprimtaritë e kryera do t'u krijojnë mundësi nxënësve të vrojtojnë, të parashikojnë dhe të regjistrojnë përfundimet.

Programi i klasës së tretë parashikon informacion për shumëllojshmërinë e trupave dhe të gjallesave, për klasifikimin e tyre, si dhe për lidhjet ndërmjet natyrës së gjallë me natyrën jo të gjallë, duke u ndalur në rolin e njeriut për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Ai synon, gjithashtu, të zhvillojë përfytyrimet e nxënësve për kohën dhe hapësirën, si dhe për ndryshimet në natyrë.

Studimi në klasën e tretë përqendrohet në humultimin e karakteristikave e të nevojave bazë të organizmave të gjalla. Nxënësit do të mësojnë aspekte të ndërtimit dhe të funksionimit të trupit të tyre, të kafshëve dhe të bimëve, si dhe do të njihen me nevojat për ushqim. Gjithashtu, nxënësit do të mësojnë disa aspekte bazë, lidhur me procesin e lindjes dhe të rritjes të njerëzimit, kafshët dhe bimët.

Vëmendje e veçantë i kushtohet problemeve të edukimit shëndetësor, i cili do të ndikojë të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme aftësitë shëndetësore të nxënësve.

Një vend të rëndësishëm zë trajtimi i marrëdhënieve ndërmjet gjallesave dhe mjedisit të tyre, duke theksuar dhe problemet e edukimit mjedisor. Gjithashtu, në të gjitha humultimet e tyre, nxënësit do të përmirësojnë aftësitë për të vëzhguar, duke përdorur të pesta shqisat, si dhe do të përpiqen të rishkruajnë vëzhgimet e tyre me detaje.

SYNIME TË PROGRAMIT

1. Sigurimi i arsimimit fillestar në shkencat e natyrës dhe aftësimi i fëmijve në procesin e fitimit dhe të zhvillimit të koncepteve elementare shkencore;
2. Zbulimi i lidhjeve ndërmjet varësisë së botës së gjallë dhe mjedisit;
3. Zhvillimi i personalitetit, sjelljeve, qëndrimeve dhe vlerave, që i aftësojnë fëmijët të bashkëveprojnë me mjedisin në mënyrë të ndërgjegjshme, të përgjegjshme dhe konsensuale.

OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË PROGRAMIT

Në përfundim të këtij klasës së tretë nxënësit duhet:

1. ***Të jenë të interesuar në lidhje me dukuritë dhe proceset natyrore, të jenë të aftë të fitojnë njohuritë përmes vëzhgimeve, matjeve, eksperimentimeve.***
 - Të vënë në dukje dhe të vëzhgojnë në një nivel elementar dukuritë natyrore (objektet, organizmat e gjalla etj.);
 - Të kryejnë nën mbikqyrjen e mësuesit, prova, vëzhgime dhe eksperimente;
 - Të vënë në dukje mjete dhe pajisje të nevojshme për vëzhgime dhe t'i përdorin ato në rrugë të mbrojtur;
 - Të jenë të familjarizuar me matje të përditshme dhe të përdorin me saktësi njësitë e vëllimit, të masës, gjatësisë, kohës, temperaturës;
 - Të sigurojnë me ndihmën e mësuesit, informacion nga burime të ndryshme.

2. *Të jenë të aftë të krahasojnë, të klasifikojnë, të përgjithësojnë njohuritë e marra nga mjedisi natyror dhe teknik; të interpretojnë përfundimet eksperimentale; të shprehin me gojë, me shkrim dhe në mënyrë grafike njohuritë e fituara.*
 - Të krahasojnë në mënyrë elementare karakteristikat sasiore dhe cilësore të objekteve të ndryshme, qenieve të gjalla dhe të dukurive natyrore;
 - Të dallojnë me ndihmën e mësuesit, ndërveprimet dhe ndryshimet në mjedisin e afërt dhe më gjerë;
 - Të bëjnë klasifikimin në grupe të caktuara të dukurive dhe proceseve në lidhje me aspekte të ndryshme;
 - Të shpjegojnë dhe të shënojnë përfundimet e vëzhgimeve dhe të përvojave të tyre të thjeshta me fjalët e veta;
 - Të interpretojnë informacione të thjeshta, të dhëna në mënyrë vizuale dhe të shkruar, të përdorin hartat dhe skicat e thjeshta.

3. *Të jenë të aftë të shpjegojnë sipas gjerësisë dhe thellësisë së informacionit që zotërojnë, dukuritë, proceset natyrore dhe përdorimet e tyre teknike; të përdorin informacionin e fituar në zgjidhjen e problemeve jetësore.*
 - Të japin shpjegime elementare për dukuritë, proceset natyrore dhe zbatimet e thjeshta teknike;
 - Të kujdesen për gjallesat dhe mjedisin që i rrethon;
 - Të kuptojnë që gjendja e mjedisit ndikon në shëndetin e njeriut dhe të ndjejnë nevojën e një mjedisi të shëndetshëm;
 - Të mendojnë rrugët në të cilat gjallesat dhe mjedisi kanë nevojë për mbrojtje.

4. *Të jenë të aftë të kuptojnë që zhvillimi i shkencës është rrjedhojë e kërkimeve të shumta për një kohë të gjatë nga ana e shkencëtarëve.*
 - Të vënë në dukje që njohuritë për natyrën janë fituar përmes vëzhgimeve, eksperimenteve, matjeve të bëra gjatë një kohe të gjatë;
 - Të dinë që shkencat e natyrës, si dhe shkencat e tjera, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve jetësore dhe në përmirësimin e standardeve të jetesës.

PROGRAMI SINTETIK

35 javë x 2 orë në javë = 70 orë

1. Trupat dhe lëndët	8 orë
2. Proceset e matjeve	9 orë
3. Lëvizja dhe vendndodhja	11 orë
4. Magnetët	4 orë
5. Bimët	6 orë
6. Kafshët	5 orë
7. Njeriu dhe shëndeti	19 orë

PROGRAMI TEMATIK

KAPITULLI 1. TRUPAT DHE LËNDËT (8 orë)

Përmbajtja tematike

1. Kuptimi për trupat
2. Trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet
3. Dallimi ndërmjet trupit dhe lëndës
4. Lëndët, vetitë dhe përdorimet e tyre
5. Lëndët ndryshojnë
6. Lëndët dhe mjedisi

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të përshkruajnë një objekt, në mënyrë sa më të plotë (p.sh., kopsa është e rrumbullakët, e vogël, e lehtë, e lëmuar, në ngjyrë të kuqe, me dy vrima, plastike, jo e tejdukshme, pa aromë, tingëllon mbytur në dysHEME, përdoret për të bashkuar dy pjesë të veshjes etj.).
2. Të krahasojnë vetitë e dy objekteve (p.sh., të dy kopsave të ndryshme ose të një kopsë dhe një monedhe metalike).
3. Të kuptojnë që një objekt mund të ketë më shumë se një veti (p.sh., molla është e kuqe, por edhe e rrumbullakët, edhe është ushqim etj.).
4. Të vënë në përdorim, sa më shumë të jetë e mundshme, të gjitha shqisat, për të përcaktuar vetitë e objektit (p.sh., bananen e shikojnë, është e verdhë, e gjatë; e prekin, është pak e butë, e lëmuar; e nuhasin, është me aromë të veçantë; e hanë, është e shijshme, frut etj.).
5. Të ndajnë objektet në dy grupe sipas një vetie të vetme (p.sh., një grup me objekte prej druri dhe tjetri me objekte metalike).
6. Të krahasojnë dy objekte brenda të njëjtit grup, për të përcaktuar ngjashmëritë dhe ndryshimet (p.sh., karriken dhe tavolinën në grupin e objekteve prej druri ose dy karrike të formave të ndryshme).
7. Të kuptojnë që i njëjti grup objektësh mund të klasifikohet me më shumë se një mënyrë (p.sh., grupi i objekteve prej druri, që shërbejnë si orendi zyre).
8. Të kuptojnë që lëndët e ngurta, të lëngëta dhe të gazta janë në gjendje në të cilat ndodhet vetë lënda (p.sh., plastelina e ftohtë dhe e ngrrohtë; akull i ngrirë dhe i shkrirë).
9. Të shqyrtojnë disa veti të lëndëve të ngurta, të lëngëta dhe të gazta (p.sh., të vizores, qumështit, ajrit në balonë).
10. Të përshkruajnë veti të ndryshme të lëndëve dhe t'i lidhin ato me përdorimin e tyre (p.sh., plastika për shishe; druri për karrike etj.).
11. Të krahasojnë vetitë e lëngjeve me ato të lëndëve të ngurta për të përcaktuar se cilat lëndë marrin formën e enës ku janë futur (p.sh., uji do ta mbushë një enë plotësisht, kurse kubat e akullit do të lenë hapësira bosh).
12. Të krahasojnë vetitë e ujit me vetitë e të paktën një lëngu tjetër (p.sh., detergjent, vaj).
13. Të dallojnë lëndët e ngurta që treten në ujë (p.sh. sheqeri) nga lëndët e ngurta që nuk treten në ujë (p.sh., rëra).

14. Të përshkruajnë, duke përdorur vrojtimit e tyre, karakteristikat e tri gjendjeve të ujit dhe të përcaktojnë kushtet që shkaktojnë ndryshimet nga një gjendje në një tjetër (p.sh., uji kthehet në akull, kur vendoset në frigorifer).
15. Të dinë që gjendjet e lëngjeve dhe të lëndëve të ngurta e të gazta mbeten të pandryshueshme në disa rrethana (p.sh., lëndët e ngurta mbeten të ngurta kur thyhen; lëngjet mbeten lëngje kur derdhen, ajri mbetet ajër kur fryhet tollumbacja), por mund të ndryshojnë në rrethana të tjera (p.sh., lëngjet mund të ngrijnë kur ulet temperatura; lëndët e ngurta mund të shkrijnë kur nxehen; avulli mund të lëngëzohet në xhamin e ftohtë).
16. Të diskutojnë mënyrat e shfrytëzimit të ndryshimeve të gjendjes së lëndës, për të vlerësuar temperaturat (p.sh., nëse uji ngrin, temperatura është nën zero gradë celcius dhe nëse vlon është mbi 100 gradë celcius).
17. Të vëzhgojnë riciklimin dhe ripërdorimin e lëndëve (p.sh., letra, pambuku, kanoçet e aluminit etj.).

KAPITULLI 2. PROCESET E MATJEVE (9 orë)

Përmbajtja tematike

1. Matja e gjatësisë
2. Matja e vëllimit
3. Matja e masës
4. Matja e temperaturës
5. Vlera mesatare e temperaturës
6. Matja e kohës
7. Zbatimi i njësive të matjes

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit të jenë në gjendje:

1. Të krahasojnë trupat për të përcaktuar përmasat e tyre relative (p.sh., molla, topi, Toka).
2. T'i grupojnë trupat sipas përmasave të tyre (p.sh., gjethet e mëdha dhe gjethet e vogla).
3. Të masin gjatësinë e trupit, duke përdorur mjetin e përshtatshëm të matjes (p.sh., gjatësinë e fletores me vizore).
4. Të vlerësojnë gjatësinë e trupave dhe të vlerave të matura (p.sh., gjatësia e librit në centimetra, kurse e klasës në metra).
5. Të shprehin gjatësinë e trupit me anë të një njësie të marrë sipas dëshirës (p.sh., gjatësia e tavolinës e matur me pëllëmbë).
6. Të dinë që masa e lëngut ruhet kur ai derdhet nga një enë në një tjetër, pavarësisht nga forma e ndryshme e tyre (p.sh., masa e ujit kur derdhet nga shishja në gotë).
7. Të përcaktojnë se cilat enë mund të mbajnë sasi më të madhe uji (p.sh., një shishe me bazë të vogël apo një me të njëjtën lartësi, por me bazë më të madhe).
8. Të masin sasinë e rërës ose të ujit, që mund të përdoret për të mbushur enë të ndryshme (p.sh., me enë të shkallëzuara cilindrike dhe peshore).

9. Të shprehin vëllimin e një trupi me anë të njësive të marra sipas dëshirës (p.sh., me cm^3 dhe me litër).
10. Të krahasojnë masën e disa trupave të ndryshëm (p.sh., të topit të pingpongut dhe të topit të tenisit).
11. Të përdorin peshoren për të matur masën e trupave të ndryshëm (p.sh., të trupit të tyre).
12. Të shprehin masën e trupit me anë të njësive të marra sipas dëshirës (p.sh., me gramë, apo me zara).
13. Të krahasojnë trupat sipas nxehtësisë së tyre (p.sh., të ujit në dhomë me ujin jashtë).
14. Të grupojnë trupat sipas nxehtësisë (p.sh., të ftohtë veç dhe të nxehtë veç).
15. Të masin nxehtësinë e trupit, duke përdorur termometrën (p.sh., të trupit të tyre ose të ujit në enë).
16. Të vlerësojnë temperaturën e trupave dhe të vlerave të matura (p.sh., 10°C është më e ulët se 20°C).
17. Të gjejnë vlerën mesatare të temperaturës (p.sh., të masin temperaturën e ajrit në 24 orë ose në një javë dhe të gjejnë vlerën mesatare të temperaturës ditore dhe javore).
18. Të shpjegojnë kuptimin e kohës, duke krahasuar intervale kohore të njohura (p.sh., orën, ditëjavën, javën, muajin etj.).
19. Të demonstrojnë kuptimin e termave kohorë: më parë, më pas (p.sh., shikoj televizor pasi mbaroj mësimet, eja ti më parë, pas teje do të vij unë etj.).
20. Të përshkruajnë veprimtaritë e njerëzve gjatë ditës dhe natës (p.sh., ditën shkoj në shkollë, natën fle etj.).
21. Të grupojnë intervalet kohore sipas gjatësisë së tyre (p.sh., koha për të mësuar me kohën për të parë televizor, koha për të ngrënë me kohën për t'u larë etj.).
22. Të shprehin gjatësinë e intervalit kohor, duke përdorur njësi matëse të ndryshme (p.sh., lëkundjet e lavjërësit; përplasjet e duarve; tik-takun e orës etj.).
23. Të masin gjatësinë e intervalit kohor, duke përdorur instrumentin e përshtatshëm (p.sh., sahatin, orën me rërë, orën diellore etj.).
24. Të shpjegojnë kuptimin e njësive standarde (p.sh., të metrit).
25. Të hamendësojnë pse njerëzit përdorin njësitë standarde të matjeve (p.sh., përdorimi i metrit, pëllëmbës, këmbëve etj.).
26. Të dinë që shumica e instrumenteve matëse përdorin njësitë standarde (p.sh., metri shirit, peshorja, termometri, kronometri).
27. Të dinë njësitë standarde të gjatësisë, të vëllimit, masës dhe temperaturës në sistemin SI (p.sh., metrin, kg, m^3 , gradë celcius, sekonda).

KAPITULLI 3. LËVIZJA DHE VENDNDODHJA (11 orë)

Përmbajtja tematike

1. Gjërat që lëvizin
2. Pse lëvizin gjërat?
3. Ku lëvizim më lehtë dhe më shpejt?
4. Drejtimi i lëvizjes
5. Llojet e lëvizjes
6. Çfarë është dhe si mund të gjendet vendndodhja e trupave?

7. Pse ky objekt ka këtë vendndodhje?

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të krahasojnë përshkrimet ose pamjet e një mjedisi në kohë të ndryshme, për të zbuluar ndryshimin (lëvizjen e makinës, duke parë nga dritarja e klasës).
2. Të përcaktojnë nëse ndryshimi i vrojtuar lidhet me lëvizjen (p.sh., pozicionin e shokut, që ka lëvizur gjatë kohës që ka mbajtur sytë mbyllur).
3. Të vrojtojnë dhe të përshkruajnë lëvizjen (p.sh., ndryshimi i pozicionit të një objekti që lëviz, sipas një drejtimi dhe trajektoreje të caktuar).
4. Të dinë të gjejnë një objekt që nuk shikohet, vetëm me anë të përshkrimit të lëvizjes në hapësirën e afërt (p.sh., të gjejë librin e fshehur diku, duke ndjekur udhëzimet për lëvizjen, si: para, majtas, drejt etj.).
5. Të dinë të orientohen gjatë lëvizjes në mjedisin e afërt, duke përdorur pikat e referimit (p.sh., para shokut të banks, mbrapa mësuesit, përballë tabelëse, afër derës, larg dritares etj.).
6. Të përshkruajnë varësinë ndërmjet vendndodhjes së objekteve dhe funksionit të tyre (p.sh., stacionit të autobuzit pranë shkollës etj.).
7. Të vëzhgojnë që objektet mund të lëvizin me shpejtësi të ndryshme (p.sh., makina dhe karroca).
8. Të diskutojnë si mund të matet lëvizja (p.sh., gjatë lëvizjes së lapsit në një fletë me kuti).
9. Të vrojtojnë lidhjen ndërmjet fërkimit dhe lëvizjes (p.sh., ecja në rërë dhe në rrugë).
10. Të vlerësojnë që lëvizja shkaktohet nga forca (p.sh., gjethet e pemës nga era).

KAPITULLI 4. MAGNETËT (4 orë)

Përmbajtja tematike

1. Ç' janë magnetët?
2. Ku përdoren magnetët?

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të klasifikojnë duke përdorur vrojtimit e tyre, materialet magnetike dhe jomagnetike dhe të përcaktojnë materialet që mund të magnetizohen (p.sh., hekur, nikel).
2. Të identifikojnë, përmes vrojtimit, ndikimin e kushteve të ndryshme në fuqinë e magnetëve në materialet (p.sh., ndikimi i largësisë ndërmjet magnetëve).
3. Të krahasojnë materialet e ndryshme duke matur fuqinë e tyre magnetike (p.sh., numri i kapseve të letrave që mund të kapen me një gjilpërë të magnetizuar).
4. Të përshkruajnë dhe të demonstrojnë se materialet e magnetizuara mund të shtyjnë ose të tërheqin materiale të ngjashme (p.sh., magneti një gjilpërë magnetike).
5. Të përcaktojnë, përmes vrojtimit, polaritetin e një magneti (p.sh., përdorimi i një magneti me polaritet të njohur për të gjetur polin e një magneti të panjohur).
6. Të përcaktojnë përdorimin e magnetëve në objektet e njohura (p.sh., magnetët e frigoriferit, busullat, gommat ngjitëse në frigorifer, kapëset magnetike të dollapëve, lodrat magnetike).

7. Të përcaktojnë materialet që mund të vendosen ndërmjet një magneti dhe një objekti tërheqës, pa cënuar fuqinë e tërheqjes (p.sh., letër e thjeshtë).
8. Të përshkruajnë, përmes observimeve, ndryshimet në forcën e tërheqjes në largësi të ndryshme si për forcat magnetike, dhe për forcat elektrike statike.
9. Të skicojnë dhe të konstruktojnë një sistem që përdor forcën magnetike për të lëvizur një objekt (p.sh., ndërtojnë një barkë që mban kapse letre dhe ta lëvizin atë në ujë me anën e një magneti).
10. Të gjejnë polet e tipave të ndryshëm të magnetëve (p.sh., të një magneti të njohur dhe një të panjohur).
11. Të përshkruajnë pjesët e një magneti, ku tërheqja është më e fuqishme (p.sh., duke vendosur një gjilpërë hekuri në pozicione të ndryshme kundrejt magnetit).
12. Të përdorin busullën për të gjetur drejtimin e veriut të magnetit.

KAPITULLI 5. BIMËT (6 orë)

Përmbajtja tematike

1. Pjesët e një bime
2. Ç'i duhet një bime për t'u rritur
3. Si lind dhe rritet bima
4. Historia e një kokre misri
5. Drurët, shkurret, barishtet.

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të përshkruajnë pjesët kryesore të bimëve (rrënja, kërcelli, gjethja, lulja, fara, fryti) dhe rolin e tyre.
2. Të provojnë se cilat janë kushtet për të cilat kanë nevojë bimët që të rriten.
3. Të përshkruajnë duke përdorur vëzhgimin, ndryshimet e bimëve gjatë ciklit të plotë të jetës së tyre (p.sh. nga fara deri në formimin e lules e frytit).
4. Të klasifikojnë bimët sipas disa karakteristikave.
5. Të përshkruajnë përshtatjen e bimëve me mjedisin (të bimëve në vendet e ngrohta, të ftohta, me lagështi, të thata etj.).

KAPITULLI 6. KAFSHËT (5 orë)

Përmbajtja tematike

1. Kafshët rruazore dhe parruazore.
2. Çfarë hanë kafshët
3. Çdo gjallesë lind nga një e ngjashme me atë

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të përcaktojnë dhe të përshkruajnë karakteristikat kryesore fizike në lloje të ndryshme kafshësh (parruazorë, rruazorë).
2. Të përshkruajnë si grupohen kafshët nga mënyra si ato ushqehen (barngrënëse, mishngrënëse, gjithshkangrënëse).

3. Të përshkruajnë si shumohen kafshët (për shembull, në disa gjallesa të vegjëlit lindin nga vezët dhe në disa të tjerë drejtpërdrejt nga nëna e tyre).
4. Të përshkruajnë ndryshimet e pamjes dhe të veprimtarisë së kafshëve, që i shoqërojnë në ciklin e plotë të jetës (p.sh., vemjet që shndërrohen në flutura, ose larvat në bretkosa).
5. Të përshkruajnë përshtatjen e kafshëve me mjedisin (në vende të ngrohta, të ftohta, shkretëtirë, zonë barishtore, oqeanë e dete etj.).

KAPITULLI 7. NJERIU DHE SHËNDETI (19 orë)

Përmbajtja tematike

1. Pamja ime. Unë dhe shqisat e mia.
2. *Si realizohet mbrojtja, lëvizja dhe mbështetja tek unë.*
3. Mjetet e higjienës dhe përdorimi i tyre (mësim praktik).
4. Shëndeti i skeletit.
5. *Të ushqyerit.*
6. Pse dhe si ushqehem?
7. Dhëmbët e mi dhe higjiena e tyre.
8. *Si marr frymë?*
9. Ajri i pastër dhe rëndësia për shëndetin.
10. *Qarkullimi i gjakut tek unë.*
11. Sëmundjet e zemrës.
12. *Jashtëqitja.*
13. Veshkat dhe shëndeti.
14. *Sistemi nervor.*
15. Sistemi nervor mund të sëmuret.
16. *Njeriu lind dhe rritet.*
17. Regjimi ditor. Nevoja për gjumë, lëvizje, kohë të lirë dhe pushim.
18. Siguria ime (ilaçet, siguria në rrugë, siguria në shtëpi).

Objektivat

Në përfundim të këtij kapitulli nxënësit do të jenë në gjendje:

1. Të përshkruajnë pjesët kryesore të trupit të njeriut dhe funksionet e tyre (p.sh., gjymtyrët për lëvizje, mushkëritë dhe hunda për frymëshkëmbim, zemra dhe enët e gjakut për qarkullim, veshkat për jashtëqitjen etj.).
2. Të përcaktojnë pozicionin dhe funksionin e çdo organi shqisor.
3. Të përshkruajnë ndryshimet bazë tek njeriu gjatë procesit të rritjes (p.sh., rritja e këmbëve, duarve, krahëve, humbja e dhëmbëve të qumështit).
4. Të diskutojnë dhe të zbatojnë rregullat kryesore të higjienës.
5. Të përshkruajnë përdorimin e ekuilibruar në dietën ushqimore të katër grupeve kryesore ushqimore (proteina, karbohidrate, yndyrna, vitamina dhe kripëra minerale) dhe demonstrimin e plotësimit të nevojave për grupet ushqimore nga burimet e natyrës (p.sh., buka është e përbërë nga prodhime natyrore, qumështi dhe mishi sigurohet nga kafshët etj.).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Realizimi i objektivave të programit varet kryesisht nga puna e mësuesit në klasë dhe cilësia e tekstit mësimor. Lënda e dituri natyrës të mësohet nga nxënësit jo vetëm nëpërmjet shpjegimit, por kryesisht nëpërmjet gjurmimeve, veprimtarive dhe diskutimit. Një metodologji aktive i ndihmon nxënësit të jenë element aktiv në të mësuarit, gjë që i mëson ata se si të nxënë në mënyrë të pavarur dhe krijuese.

Tërheqja e nxënësve në kërkime të ndryshme të zërë mjaft vend në të mësuarit e diturisë së natyrës. Gjatë vëzhgimeve të qenieve të gjalla, të dukurive apo gjatë konsultimeve me fotografi, harta, postera e burime të tjera informacioni, nxënësit të nxiten të mbajnë shënime. Në këtë mënyrë, ata do të thellohen e do të kuptojnë më mirë objektin apo dukurinë që vëzhgojnë.

Kërkesa për mbajtjen e shënimeve dhe paraqitjen e gjetjeve gjatë vëzhgimeve dhe eksperimenteve ndihmon pozitivisht në përpunimin e të dhënave dhe përvetësimin e njohurive. Për shënimet dhe paraqitjen e përfundimeve nga nxënësit, mund të parashikohen forma të tilla pune, si: shkrimi i një relacioni, përgatitja e një informacioni gojor, realizimi i një vizatimi, tabele apo grafiku etj.

Në shkrimin e relacioneve, apo paraqitjen e informacioneve gojore etj., është mirë që gjithnjë të kërkohet nga nxënësit që të analizojnë, të krahasojnë dhe të përgjithësojnë të dhënat në mënyrë që të nxitet të kuptuarit e dukurisë ose të objektit të vëzhguar.

Nxënësit e një klase shpalosin në mësim përvoja të ndryshme, interesa dhe aftësi të ndryshme. Teksti e mësuesi të japë një larmi veprimtarish mësimore, ku secili nxënës të mund të gjejë veten dhe të ketë për të bërë diçka në lidhje me temën mësimore. Për këtë arsye, në program janë parashikuar orë në dispozicion të mësuesit. Nga ana tjetër, orët e parashikuar për secilin kapitull në program, përmbajnë në vetvete një shkallë të lehtë fleksibiliteti. Varet nga mësuesi numri i saktë i orëve për një kapitull të caktuar.

UDHËZIME TË VLERËSIMIT

Vlerësimi i njohurive të nxënësve është një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit. Vlerësimi i nxënësit është një përgjegjësi e rëndësishme dhe kërkon të mbështetet në parametra bashkëkohore.

Vlerësimi përdoret:

- Për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm për përparimin e nxënësve, motivimin e tyre drejt të mësuarit, duke përcaktuar mundësitë reale të nxënësve për nxënie të mëtejshme ;
- Për të vlerësuar përparësitë, dobësitë në arritjet e nxënësve dhe shkaktarët e situatës së dhënë ;
- Për të nxjerrë të dhëna për arritjet përfundimtare të nxënësve gjatë të mësuarit.

Nisur nga qëllimi i realizimit, vlerësimi klasifikohet në formues, diagnostikues, përmbledhës, motivues.

Vlerësimi formues synon marrjen e informacionit për atë që ka arritur të përvetësojë nxënësi krahasuar me objektivin mësimor. Ky informacion i nevojitet mësuesit për të ndërhyrë dhe për të ndryshuar mësimdhënien, duke siguruar kalimin në objektiva të rinj mësimorë, vetëm pasi të jenë arritur objektivat mësimorë paraprakë.

Vlerësimi diagnostikues përdoret për aspekte të përvetësimit të njohurive nga nxënësit, për të gjykuar për atë që ata kanë mësuar ose nuk e kanë mësuar. Ky tip vlerësimi përdoret për të marrë informacion për përgatitjen ditore të nxënësve dhe shkallën e përvetësimit nga ta të materialit të ri mësimor, ai jep informacion për frytshmërinë e të nxënësve dhe ndihmon për ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës bëhet në përputhje me objektivat mësimorë në fund të semestrit, të vitit ose në fund të studimit të disa kapitujve mësimorë. Ai jep informacion për atë çfarë kanë arritur të nxënë dhe të bëjnë nxënësit gjatë një kohe të dhënë. Është mirë të parashikohen disa vlerësime përmbledhëse gjatë vitit.

Vlerësimi motivues ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuarit. Vlerësimi motivues përbën një ndër format më të frytshme që mund të përdoret në drejtim të nxitjes së të mësuarit tek nxënësit.

Praktika shkollore kërkon planifikimin e gjithë tipave të mësipërm të vlerësimit, kjo në varësi të momentit të të mësuarit të përmbajtjes lëndore.

Ndërtimi i vlerësimit bazohet në pyetjet e kërkesa, që u takojnë niveleve të ndryshme të njohjes. Kështu kemi:

1. Pyetje e kërkesa të nivelit të njohjes, të cilat, megjithëse janë të nivelit më të ulët të të menduarit, janë mjaft të rëndësishme gjatë të mësuarit, mbasi nxënësit përdorin kujtesën për zotërimin e mjaft njohurive dhe që medoemos duhet të kalojë përmes riprodhimit të thjeshtë mekanik.

Në këtë këndvështrim, pyetjet e kërkesat e nivelit të njohjes janë të domosdoshme gjatë të mësuarit. Vetëm se ato të bëhen në masën e duhur, pa u tepruar në kurriz të pyetjeve të niveleve të tjera të njohjes që, gjithashtu, janë tepër të nevojshme për përvetësimin e koncepteve shkencore nga nxënësit.

Pyetje e kërkesa të këtij lloji janë, p.sh. :

- Trego disa trupa të ngurtë, lëngje etj.
- Cila është përbërja e ajrit ?

2. Pyetje kërkesa të nivelit të të kuptuarit, të cilat testojnë njohuritë e nxënësve në një nivel më të lartë se pyetjet e e kërkesat e njohjes. Ato lidhen me kërkesat: interpreto, parashiko, përgjithëso, argumento etj. Këto pyetje e kërkesa i drejtojnë nxënësit të ndryshojnë informacionin nga një formë në një tjetër ose të përshkruajnë lidhjen ndërmjet dy a më shumë koncepteve.

Pyetje e kërkesë e tillë, p.sh., është:

- Shpjego pse qelqi, plastika, druri janë lëndë etj.

3. Pyetje kërkesa të nivelit të zbatimit, të cilat kërkojnë nga nxënësit të përdorë informacionin e mësuar për të zgjidhur probleme të reja. Disa folje që përdoren në ndërtimin e pyetjeve e kërkesa të zbatimit janë: demonstro, zhvillo, opero, përgatit, përdor, lidh etj. Pyetje e kërkesat e këtij niveli, p.sh., janë :

- Demonstro në rrugë eksperimentale ndryshimin e gjendjes agregate të ujit.

4. *Pyetjet e kërkesat e analizës* janë të nivelit të lartë. Ato kërkojnë nga nxënësit përmes përdorimit të logjikës, të zbërthejnë diçka në pjesët përbërëse apo të kërkojnë lidhjet ndërmjet dy a më shumë gjërave. Analiza e lidhjeve shkak-pasojë, gjithashtu, përbën një terren të gjerë për formulimin e pyetjeve të analizës. Disa nga foljet e përdorura në ndërtimin e pyetjeve e të kërkesave të analizës janë: *ilustro, nënvizo, dallo, diferenco, trego, nda etj.*

Kërkesë e këtij tipi, p.sh., është :

- *Dallo lëndët dhe trupat në pohimet që vijonë: metal, hekur rrobash, karrike, dru, letër, revistë etj.*

5. *Pyetjet e e kërkesat e sintezës*, në përgjigjen e tyre nxënësit rendisin përmbajtjen e mësuar më parë për të krijuar një prodhim të ri. Një kërkesë sintezë, p.sh., është :

- *Gjej në klasë llojet e lëndëve nga të cilat janë përbërë trupat e ndryshëm dhe trego se ku këto lëndë gjejnë përdorime të tjera.*

Pyetjet e e kërkesat e sintezës zakonisht nuk kanë vetëm një përgjigje të saktë, ato mund të jenë disa. Ndër mënyrat e hartimit të pyetjeve e të kërkesave të sintezës është dhe ajo e lidhjes së përmbajtjes së mësimit me probleme të jetës së përditshme.

6. *Pyetjet e vlerësimit* që kanë për qëllim që nxënësit të gjykojnë rreth diçkaje. Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve nxënësit ndjekin dy hapa kryesorë: a) të vendosin kriteret e vlerësimit, b) të gjykojnë sipas kriterëve të vendosura. Pyetje të tilla mund të hartohen p.sh., rreth objekteve teknologjike, gjendjes së ekosistemeve në zonën afër shkollës etj.

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve bëhet përmes një numri të madh teknikash vlerësimi. Ato janë:

1. Vlerësimi me shkrim (testet);
2. Vlerësimi gojor;
3. Vlerësimi me anën e dëgjimit;
4. Vlerësimi praktik;
5. Vlerësimi me anën e pyetësorëve të nxënësve;
6. Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore, punëve në terren.

Është e këshillueshme që informacioni për shkallën e nxënies së nxënësve të merret sipas rastit duke përdorur secilën nga teknikat e mësipërme.

UDHËZIME PËR HARTIMIN E TEKSTIT

Për hartimin e teksteve me parametra të lartë shkencorë dhe metodikë, autorët e tyre të udhëhiqen nga parimet dhe kriteret mëposhtme:

1. Parime të përgjithshme

Hartimi i teksteve është proces, që në të gjitha etapat e tij kërkon:

1. Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me këtë program të lëndës së dituri të natyrës për klasën e tretë;

2. Të vlerësojë përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera në hartimin e teksteve të shkencës për arsimin fillor;

3. Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës së kësaj moshe;

4. Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore në mësimdhënien e koncepteve të shkencës për këtë nivel shkollimi;

5. Të ketë parasysh mundësitë aktuale për sigurimin e bazës materiale të nevojshme mësimore nga shkollat tona, në qytet dhe fshat;

6. Të vlerësojë shkallën aktuale të zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe, në përshtatje me moshën, të pasqyrojë dukuritë e reja shoqërore që lidhen me jetën e nxënësve;

7. Të synojë të luajë rol nxitës për ide novatore në mësimdhënien dhe mësimnxënien e lëndës;

8. Të synojë jo vetëm në përfitimin e njohurive shkencore e të shprehive si rrjedhojë të aftësive të caktuara, por edhe në edukimin e atyre qëndrimeve e vlerave të cilat e mundësojnë nxënësin për të gjetur gjithnjë e më mirë vendin e tij në shoqëri dhe familje;

9. Të synojë realizimin e një dokumenti me karakter fleksibël, duke i lënë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

2. Krite shkencore

1. Gjerësia e koncepteve shkencore dhe e aftësive përkatëse të jetë në përputhje me parashtrimet në këtë programin e diturisë së natyrës për klasën e tretë, të miratuar nga MASH. Ai të përmbushë të gjitha objektivat mësimorë që përmbahen në të;

2. Autorët ta përkthejnë programin mësimor në mënyrë krijuese. Ata, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe duke patur përceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor progresi në konceptimin e mësimdhënies së koncepteve, të dukurive shkencore të programuara. Për këtë, autorët të përdorin lirinë e tyre në përcaktimin e mënyrave, rrugëve të frytshme për arritjen e objektivave të shpallur ose të pashpallur (të nënkuptuar të programit), si dhe aparatit pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave lëndorë;

3. Pavarësisht nga mënyra e trajtimit, konceptet e zhvilluara në tekst të kënaqin rigoroze të shkencor;

4. Dhënia e koncepteve të bazohet në veprimtari të shumta dhe të larmishme të nxënësve që në mënyrë të natyrshme dhe konkrete ta shpien atë drejt thelbit të konceptit, dukurisë;

5. Konceptet e aftësitë të ngrihen mbi *përvojën reale* të nxënësve dhe përmes situatave konkrete, duke përdorur elemente me të cilat nxënësi është i familjarizuar ose e ka të lehtë të familjarizohet;

6. Teksti të japë mundësi për të sjellë në klasë realitetin familjar e shoqëror që rrethon nxënësit, mjediset ku ai jeton, për të kuptuar në kënvështrimin e shkencës atë që shihet dhe atë që nuk shihet, por që duhet të zbulohet, të hulumtohet, të kuptohet, të ndryshohet etj.;

7. Informacioni në shërbim të koncepteve të jepet nëpërmjet fjalës së shkruar dhe ilustrimeve me ngjyra (skica, piktura). Ilustrimet të jenë në shërbim të konceptit, idesë shkencore, po ashtu dhe të kënaqësisë estetike, por pa e tepruar në favor të kësaj të fundit;

8. Të mënjanohet në tekst përdorimi i shablloneve që thjesht duhen imituar dhe që pengojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësve

3. Krite didaktike

1. Teksti i diturisë së natyrës për klasën e tretë të konceptohet si mjet pune për nxënësin dhe të hartohet në mënyrë të tillë që ai të bashkëpunojë me kënaqësi me të;

2. Zhvillimi i koncepteve t'i drejtohet përvojës së nxënësve, duke përfshirë diskutimin e situatave të caktuara, sigurimin e pjesëmarrjes së tyre për zgjidhjen e probleme të veçanta, si, p.sh., të ruajtjes dhe të mbrojtjes së mjedisit;

3. Zhvillimi i koncepteve vazhdimisht të zhvillojë të menduarit kritik e krijues të nxënësve;

4. Teksti të përmbajë mësim ose struktura mësimore të qarta, në formën e njëjësive mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimore në përputhje me programin dhe me standardet lëndore;

5. Larmia e detyrave në tekst të jetë e tillë, që t'i japë mundësi çdo nxënësi të zgjedhë dhe të gëzojë *suksesin e tij në të mësuarit e lëndës*;

6. Dimensionimi i trajtimeve konceptuale t'i lerë hapësirat e nevojshme mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike;

7. Përdorimi i ngjyrave dhe i kontrasteve të ketë parasysh të mos dëmtojë shëndetin e nxënësve;

8. Informacioni nëpërmjet fjalës së shkruar, të përbëhet nga fjalë dhe fjali të shkurtra dhe të qarta;

9. Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (tituj, tekste, figura, pyetësorë, detyra, përmbledhje etj.) të jetë tërheqës dhe i mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe të temës, në veçanti.

Numri i faqeve 140 A4, me katër ngjyra. Formati 210 x 300 mm.